



Pran. i datë: 26-07-2018		
Prilipjano:		
Presia Kuvendi	Numri i aktit	Titulli i aktit
12-320	-24669	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të neneve 12, 19 dhe 20 të paragrafit 2 të Rregullores për kushtet, kriterët dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e datës 28.12.2016, dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënjen e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerë 15Nr.400 –20212 i datës 29.03.2018, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari bën këtë:

SHPALLJE

I. Qëllimi i shpalljes për aplikim

Qëllimi i shpalljes për aplikim është përkrahja e fermerëve për vitin 2018, fermerët do të përkrahen me serra në sipërfaqe prej 50 m², dhe me motokultivator.

II. Kriteret për aplikim për serra

- Fermerët nga Komuna e Lipjanit
- Toka me qenë në territorin e Komunës së Lipjanit
- Fermerët duhet të posedojnë sipërfaqe të mjaftueshme të tokës së paku 100m²
- Kushtet socio-ekonomike të aplikuesit
- Përparësi kanë fermerët që nuk kanë përfituar në dy vitet e fundit
- Përparësi kanë fermerët të cilët dëshmojnë që kanë vijuar trajnime relevante/specifike në lëmin e perimkulturës.
- Përparësi kanë aplikuesit që kanë burime të mjaftueshme të ujitjes.

III. Kriteret për aplikim për motokultivator

- Fermerët nga Komuna e Lipjanit
- Toka me qenë në territorin e Komunës së Lipjanit
- Kushtet socio-ekonomike të aplikuesit
- Përparësi kanë fermerët që nuk kanë përfituar në dy vitet e fundit

IV. Dokumentet e bashkangjitura

Aplikuesit duhet të dorëzojnë aplikacionin së bashku me dokumentet e bashkangjitura:

- Kopja e letërnjoftimit
- Fletëposedim për patundshmëri,
- Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë,
- Konfirmimin nga banka për xhironlogarinë e aplikuesit,

V. Koha dhe mënyra e pranimit të aplikacioneve

- Data e fillimit të dorëzimit të formularit për aplikim është dita pasi të jetë publikuar thirrja për aplikim,
- Thirrja për aplikim do të jete e hapur 15 ditë pune nga data e publikimit,
- Aplikacioni për plotësim mund të shkarkohet nga web-faqja e Komunës ose mund të merret në zyret e Drejtoratit të Bujqësisë dhe së bashku me dokumentat e bashkangjitura duhet të dorëzohet në zyret pritëse të Arhives së Komunës

VI. Përzgjedhja

- Aplikimet kontrollohen, përzgjidhen dhe vlerësohen brenda afatit prej 20 ditë pune, nga dita e fundit e dorëzimit të aplikacionit në kuadër të thirrjes aktuale për aplikim,
- Pasi që aplikacioni të jetë kontrolluar sa i përket tërësisë dhe përshtatshmërisë verifikohet aplikacioni në terren nga komisioni,
- Komuna e Lipjanit do të lidhë Marrëveshje me përfituesin e serrës ose të motokultivatorit i cili obligohet që të mos e bëj tjetërsimin (shitje, dhënje në shfrytëzim etj.)

➤ **Sqarim:**

- Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet brenda periudhës së aplikimit. Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar dhe i pakompletuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.

➤ **Vërejtje:**

- Aplikimi mund të bëhet vetëm për një të njënjë masë (për serrë në sipërfaqe prej 50 m² apo për motokultivator).

Lipjan

24.04.2018

Drejtori i Bujqësisë
Shefqet Amrllahu

